



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI

PROVIMET KOMËTARE TË ARSIMIT BAZË 2024

Lënda: Matematikë

Udhëzime për nxënësin:

Testi përmban gjithsej 50 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 25 pyetje.

Për pyetjet me alternativa rrethoni vetëm përgjigjen e saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6
Pikët						
Kërkesa	7	8	9	10	11	12
Pikët						
Kërkesa	13	14	15a	15b	16	17a
Pikët						
Kërkesa	17b	18a	18b	19	20	21
Pikët						
Kërkesa	22	23	24	25a	25b	25c
Pikët						

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Për pyetjet 1-13 rrethoni vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Shifra e të dhjetave tek numri 35,142 përfaqësohet nga numri:


1 pikë

- A) 5
- B) 4
- C) 2
- D) 1

2. Një kuti me shkrepe kushton 30 lekë. Një klient blen 6 kuti shkrepeje dhe bën pagesën tek arka me një kartëmonedhë 200 lekëshe. Sa lekë i kthehen klientit?

1 pikë

- A) 10 lekë
- B) 20 lekë
- C) 30 lekë
- D) 40 lekë



3. Nëse $7^x = 49$, atëherë vlera e x^2 është:

1 pikë

- A) 7
- B) 4
- C) 2
- D) 1

4. Një i porsalindur e kishte gjatësinë 51 cm. Pas tre muajsh ai u zgjat me 8%. Afërsisht sa centimetra u zgjat foshnja?


1 pikë

- A) 4 cm
- B) 5 cm
- C) 6 cm
- D) 7 cm

5. Më poshtë jepet diagrami për bashkësitë A dhe B . Sa elementë ka bashkësia $A \cup B$?

1 pikë

- A) 6
- B) 7
- C) 10
- D) 13



6. Një atlet vrapoi për 72 minuta. Koha në orë e vrapimit të atletit është:

1 pikë


- A) 1,4 orë
- B) 1,3 orë
- C) 1,2 orë
- D) 1,1 orë



7. Shuma e këndeve të brendshme të shumëkëndëshit të rregullt, i cili paraqitet në figurë është:

1 pikë

- A) 620°
- B) 540°
- C) 480°
- D) 360°



8. Vlera e shprehjes numerike $\sqrt{16} + \sqrt{9}$ është:

1 pikë

- A) 25
- B) 19
- C) 13
- D) 7

9. Molekula e oksigjenit O_2 e ka diametrin $0,3 \times 10^{-9} m$.

Kjo përmasë e shkruar në formë standarde është:

1 pikë


- A) $3 \times 10^{-10} m$
- B) $30 \times 10^{-10} m$
- C) $3 \times 10^{-8} m$
- D) $30 \times 10^{-8} m$

10. Ana ndërtoi në rrjetin koordinativ drejtëzën me ekuacion $y = -0,4x + c$.

Nisur nga ky grafik vlera e c është:

1 pikë

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) 5



11. Jetmiri mbledhi ditën e parë x guaska. Ditën e dytë ai mbledhi tre guaska më shumë se dyfishin e guaskave të ditës së parë. Shprehja, e cila jep numrin e guaskave që mbledhi Jetmiri për dy ditë është:

1 pikë


- A) $2x+3$
- B) $2x+6$
- C) $3x+6$
- D) $3x+3$

12. Në figurë paraqiten trekëndëshat e ngjashëm $\triangle ABC$ dhe $\triangle DEF$.

Vlera e të panjohurës x është:

1 pikë

- A) 4 cm
- B) 5 cm
- C) 6 cm
- D) 10 cm



13. Një kuti ka 20 çokollata, nga të cilat 12 janë çokollatë e zezë dhe pjesa tjetër çokollatë e bardhë.

Nxirret rastësisht një çokollatë nga kjo kuti. Probabiliteti që ajo të jetë e bardhë është:

1 pikë

- A) 0,1
- B) 0,2
- C) 0,4
- D) 0,8

Pyetjet 14-25 janë me zhvillim dhe me arsytim.

14. Shkruani si një thyesë të vetme shprehjen:

2 pikë

$$\frac{1+3a}{a+b} - \frac{a}{a+b} - \frac{1-b}{a+b}$$

15. Gjatësia e vijës bregdetare të Shqipërisë është 427 km. Vendi ynë laget nga deti Adriatik dhe deti Jon. Gjatësia e vijës bregdetare e detit Adriatik është 273 km.



a) Sa km është gjatësia e vijës bregdetare e vendit tonë, e cila laget nga deti Jon?

1 pikë

b) Në hartën e Shqipërisë me shkallë zvogëlimi 1: 2 500 000, gjeni sa centimetra është gjatësia e vijës bregdetare e detit Jon.

2 pikë

16. Zgjidhni inekuacionin $2(x-1) \geq 3x+1$.

Paraqisni bashkësinë e zgjidhjeve në një bosht numerik.

3 pikë

17. Një piktor përzien bojën e kuqe me bojën e bardhë në raportin 2 : 5 për të përfutur bojën rozë.

a) Sa litra bojë të bardhë duhet të përziejë ai me 0,8 litra bojë të kuqe?

2 pikë

b) Do të lyhet fasada e një ndërtese, e cila e ka syprinën $128 m^2$

Nëse për lyerjen e $100 m^2$ sipërfaqe nevojiten 25 litra bojë, sa litra bojë nevojiten për të lyer gjithë fasadën?

2 pikë

18. Jepet vargu aritmetik 10; 7; 4; ...

a) Cila është kufiza e parë negative e këtij vargu?

2 pikë

b) Gjeni formulën e përgjithshme të vargut.

2 pikë

19. Shkruani ekuacionin e drejtëzës që kalon nga pika $P(1;1)$ dhe e ka koeficientin këndor $m = -2$


2 pikë

20. Më poshtë paraqitet skema e një makine funksion.

Vlera e një numri në hyrje është e barabartë me vlerën e numrit në dalje.

Gjeni vlerën e këtij numri. Tregoni arsyetimin tuaj.

2 pikë




21. Në figurë paraqitet rrethi me qendër O dhe rreze 7 cm .

Tangjentja AB me rrethin e ka gjatësinë afërsisht $21,5\text{ cm}$.

Bazuar tek të dhënat në figurë, gjeni syprinën e zonës së hijezuar.

Përdorni në njehsimet tuaja $\pi = \frac{22}{7}$.

3 pikë



22. Një parcelë ka formën e një trapezi kënddrejtë me sipërfaqe $216 m^2$.


Siç tregohet në skicën e mëposhtme, njëra anë e parcelës kufizohet nga një rezervuar uji.

Arbeni ka vetëm 50 metra tel për rrethimin e anëve të parcelës që nuk kanë kontakt me ujin.

Bazuar tek të dhënat e skicës tregoni, a ka mjaftueshëm tel Arbeni?

Mbështesni përgjigjen tuaj përmes njehsimeve matematikore.

3 pikë



23. Një familje prej 7 personash shkuan në kinema për të parë një film.

Bileta për të rritur kushtonte 500 lekë, ndërsa për fëmijët çmimi i biletës përgjysmohej.

Ata shpenzuan gjithsej 2 500 lekë për blerjen e biletave.

Gjeni sa të rritur dhe sa fëmijë ka kjo familje.

3 pikë

24. Një copë metalike në formën e një kuboidi me përmasa $7,5cm \times 2,8cm \times 3cm$ do të shkrihet për të formuar disa kuba metalikë me brinjë $2cm$.

Vesa thotë se do të formohen më pak se 8 kuba të tillë.

A ka të drejtë Vesa?

Mbështesni përgjigjen tuaj përmes njehsimeve të nevojshme matematikore.

3 pikë



25. Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi shpërndarjen e probabiliteteve të uljes në kohë ose jo të një avioni të rastësishëm në aeroportin Nënë Tereza në Tiranë.

<i>Mbërritja</i>	<i>Herët</i>	<i>Me vonesë</i>	<i>Në kohë</i>
<i>Probabiliteti</i>	0,04	0,66	<i>a</i>



a) Sa është probabiliteti që një avion i zgjedhur rastësisht të ulet në kohë?

2 pikë

b) Ditën e hënë në këtë aeroport do të ulen gjithsej 150 avionë.
Sa prej tyre do të ulen me vonesë?

1 pikë

c) Ditën e martë u ulën në orarin e parashikuar (në kohë) 60 avionë.
Sa avionë janë ulur gjithsej ditën e martë në këtë aeroport?

2 pikë